

UDHËZIM
Nr.115, datë 4.8.2011

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR.277, DATË 18.6.1997 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBRIT, TË NDRYSHUAR”

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, në zbatim të pikës 16 të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.277, datë 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.277, datë 18.6.1997, është 10 600 (dhjetë mijë e gjashtëqind) lekë në muaj. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i të verbrit.

2. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2011 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2011, për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në programin “Mbrojtja Sociale”, Tit.10 430, kap.1, art.606.

3. Udhëzimi nr.2209, datë 25.11.2010 i Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të barabarta, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga 1.9.2011.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera